



Prishtinë, 28 mars 2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1121\_2019

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Vendimin për lëshimin e Autorizimin Final V\_568\_2013 të datës 24 tetor 2013 lëshuar shoqërisë "KelKos Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Lumëbardhi II. në rrjedhën e lumit Deçan me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, ZK Deçan, komuna e Deçanit;
- Njoftimin nga ZRRE Nr. 016/18 të datës 19.01.2018 lidhur me projektin e ndërtimit të gjeneratorit të ri nga BRE/uji HC Lumëbardhi II., i autorizuar me Vendimin e ZRRE Nr. V\_568\_2013 të datës 24.10.2013,
- Njoftimin e KOSTT Nr. 234/01 të datës 05.03.2018 për shkelje të Marrëveshjes për Kycje, Kodin e Rrjetit, Rregullat e Tregut,
- Njoftimin e KOSTT Nr. 328/07 të datës 27.03.2018 për mos eliminimin e shkeljes të Marrëveshjes për Kycje, Kodit të Rrjetit, Rregullave të Tregut, dhe
- Njoftimin e KOSTT Nr. 611/01 të datës 17.05.2018 për shkelje të marrëveshjes për Kycje, Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut,

në seancën e mbajtur me datë 28 mars 2019 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. NDËRPREHET DHE SHKYÇET** - nga Rrjeti i Sistemit të Transmetimit (KOSTT), Gjeneratori HC Lumëbardhi II., i shoqërisë Kelkos Energy SH.P.K., i ndërtuar sipas Vendimit për Autorizimin Final V\_568\_2013 të datës 24 tetor 2013, deri në kompletimin e kërkesave ligjore të kërkuara me legjislacionin në fuqi.
- II. OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Transmetimit KOSTT që të ndërmarr veprimet e nevojshme për të përjashtuar nga Rregullat e Tregut, të vendos kufizimet ndaj aktiviteteve tregtuese për të mos lejuar rritjen e borxhit, të pezulloj të drejtën për dorëzimin e nominimeve dhe për pranimin e raporteve të tregut dhe të dhënave të tregut, dhe **URDHËROHET** - De-energizimi i stabilimenteve të HC Lumëbardhi II., deri në plotësimin e kërkesave ligjore.



- III. Vendimi do të mbetet në fuqi derisa të sillet Certifikata e Përdorimit dhe Leja Mjedisore të lëshuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH) dhe të Licencohet për gjenerim të energjisë elektrike sipas Rregullës për Licencim të aktiviteteve në Kosovë të nxjerr nga Bordi i ZRRE.

## Arsyetim

- ZRRE, më 09.08.2010 nga shoqëria “KelKos-Energy” SH.P.K. ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Lumëbardhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, komuna e Deçanit, Republika e Kosovës.
- Bordi i ZRRE-së me datë 11 nëntor 2010 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_296\_2010, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohej me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, më 24.10.2013 ka vendosur që shoqërisë “Kelkos-Energy” sh.p.k., t’i lëshohet Autorizimi V\_568\_2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Lumëbardhi II, me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, njësia gjeneruese që do të vendoset në lokacionin e lumit Deçan të komunën e Deçanit.
- ZRRE me datë 07.12.2017 nga përfaqësuesi i shoqërisë KelKos Energy SH.P.K., është informuar se nga data 01.12.2017 hidrocentrali HC Lumëbardhi II., ka hy në fazën testuese. ZRRE është njoftuar se është ndryshuar kapaciteti instalues për HC Lumëbardhi II.
- ZRRE, me datë 19 janar 2018 me shkresë zyrtare ka njoftuar aplikuesin, KOSTT, KEDS, KESCO dhe MMPH, se gjeneratori HC Lumëbardhi II., nuk mund të hyn në operim pa u plotësuar kushtet ligjore dhe atë: Modifikimi i Vendimit për Autorizim Final Nr. V\_568\_2013 të datës 24.10.2013 (ndërrimi i kapacitetit nga 5.5 MW në kapacitetin e instaluar prej 6.2 MW), ndryshimi i Lejes Ujore sipas kapacitetit të propozuar nga MMPH dhe sjellja e certifikatës së përdorimit.
- ZRRE me datë 21.12.2018, nga shoqëria KelKos Energy SH.P.K., ka pranuar kërkesën për marrjen e Licencës për Prodhimin të Energjisë Elektrike, dhe pas vlerësimit të aplikacionit ka vlerësuar se mungon Certifikata e Përdorimit dhe Leja Mjedisore e lëshuar nga MMPH, dhe nga ajo kohë e deri më tani është në pritje të sjellës nga aplikuesi, në mënyrë që të lëshohet edhe licenca formale sipas Rregullës për Licencim të ZRRE-së.
- ZRRE me datë 01.03.2019 nga Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar “Informatë për ZRRE”, me të cilën ka njoftuar se citoj “ *Operatori ekonomik “KelKos Energy” SH.P.K., nuk ka përfunduar të gjitha procedurat administrative – ligjore pranë MMPH, për projektin “ Ndërtimin e Hidrocentraleve në Lumëbardhë të Deçanit, dhe si rrjedhojë nuk janë plotësuar kriteret ligjore për operim”* .
- MMPH, në shkresën e saj ka theksuar se përgjatë ndërtimit të HC-ve, janë përcjellur në vazhdimësi punimet nga Inspektorati i MMPH, dhe ka sqaruar se kompania KelKos Energy SH.P.K., nuk është pajisur me Leje të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga MMPH, për shkak se nuk ka pasur aplikime nga investitori dhe si rrjedhojë nuk janë kryer pikat 5 dhe 6 të “Informatës për ZRRE”.



- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha shkresave dhe kërkesave të MMPH, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


IV. Shoqëria "Kelkos Energy" SH.P.K., duhet të pajiset me Leje të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga MMPH, dhe brenda afateve të rregullta ligjore Bordi i ZRRE do të lëshon Licencën për prodhim të energjisë elektrike dhe futjen e gjeneratorit HC Lumëbardhi II. në operim.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KOSTT,
- KelKos Energy SH.P.K.,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.